

Universiteti i Sporteve të Tiranës përbehet nga 4 (katër) njësi kryesore:

I-FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES ofron programet me kohë të plotë të studimeve:

- 1-Bachelor “Shkenca e Lëvizjes”
- 2-Master Shkencor “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor”;
- 3-Master i Shkencave “Shkenca Sportive”;
- 4-Cikël i tretë studimeve Doktoraturë në Shkenca Sportive.

II-FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT, është krijuar rishtazi në vitin 2019 dhe ofron program studimi në Bachelor “Shkenca të Rehabilitimit”.

III-FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT ofron programet me kohë të plotë të studimeve :

- 1-Bachelor “Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit”;
- 2-Master Profesional “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi”
- 3-Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”;
- 4-Master i Shkencave “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”;
- 5-Cikël i tretë studimeve Doktoraturë në Aktiviteti Fizik dhe Shëndet.

IV- INSTITUTI I KËRKIMIT SHKENCOR TË SPORTIT ka për mision:

- A-Kërkimin në fushën e performancës sportive;
- B-Kërkimin në fushën e aktivitetit fizik dhe shëndetit;
- C-Kërkimin në fushën e projekteve dhe teknologjisë.



UST
UNIVERSITETI I SPORTEVE
TË TIRANËS



www.ust.edu.al
[ust_faqa_zyrtare](#)
Sports University of Tirana
Sports University1958

Rruga “Muhamet Gjollësia” 1001
Tiranë - Shqipëri



Universiteti i Sporteve të Tiranës është i vetmi institucion i lartë publik i këtij lloji në Republikën e Shqipërisë në funksion të përgatitjes së mësuesve të edukimit fizik, specialistëve të sportit, të fitnesit dhe aktivitetit fizik për shëndet, menaxherëve të sportit e turizmit si dhe si dhe specialistë të fushës së rehabilitimit.

Nga viti 1958 e deri më sot, Universiteti i Sporteve të Tiranës si institucion unik në vendin tonë ka diplomuar në mënyrë sistematike Mësues, Trainerë dhe Specialistë të Lartë të Fushës të Edukimit Fizik, Sportit, Fitnesit, Rekreacionit e Rehabilitimit.

UST është një institucion i akredituar maksimalisht për 6 vite nga Agjensia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e lartë (ASCAL) dhe gëzon një reputacion të shkëlqyer si në Shqipëri ashtu edhe jashtë vendit.

UST

Universiteti i Sporteve të Tiranës ka për mision:

- a) Formimin universitar të studentëve e të specialistve në të gjitha ciklet e studimeve;
- b) Kualifikimin e punonjësve akademik e shkencor në fushat e edukimit dhe sporteve, veprimtarisë fizike, shëndetit dhe rekreacionit;
- c) Nxitjen e kërkimeve e të studimeve në fushat e edukimit fizik dhe sporteve, veprimtarisë fizike, shëndetit dhe rekreacionit;
- d) Ofrimin e shërbimeve për të tretët dhe konsulencë në fushën e edukimit fizik dhe sporteve, veprimtarisë fizike, shëndetit dhe rekreacionit.